

## Vendim nr. 312 datë 18.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Sandër Beci, Anëtar

në datën 18.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** PËRPARIM BRAÇE

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 11 akti, datë 10.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2142, datë 10.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-503, datë 21.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 18, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Përparim Braçe është pronar i një ndërtese 7+1 kate, të ndodhur në rrugën “Muhamet Gjollësia”, Tiranë, të ndërtuar në vitet 1992-1996. Në muajin tetor të vitit 1994 shtetasi L.L. ka porositur një apartament 4+1 në katin e tretë të pallatit. Në muajin mars të vitit 1995 ky shtetas ka porositur një kat për t’u përshtatur si hotel, duke e bashkuar me një kat tjetër në pronësi të kërkuesit. Në datën 06.06.1995 kërkuesi dhe shtetasi L.L. kanë nënshkruar një aktmarrëveshje me objekt themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për ndërtimin, përshtatjen dhe shfrytëzimin e këtij hoteli, në katet 6 dhe 7 të ndërtesës, prej 300 m<sup>2</sup> secili kat dhe 140 m<sup>2</sup> sipërfaqe në katin përdhe. Kjo marrëveshje ka parashikuar dhe kontributet e veçanta dhe të përbashkëta të palëve, si dhe subjektet të cilave do t’u përkasë pronësia e objektit pas përfundimit të plotë të tij. Ndërsa marrëveshja është zbatuar, mes palëve ka lindur mosmarrëveshje, për zgjidhjen e së cilës ka pasur një proces gjyqësor civil dhe, në vijim, në lidhje me të, edhe një proces penal të kundërshtuar përmes ankimit kushtetues individual, në rastin konkret.

#### *Procesi gjyqësor civil*

2. Në datën 04.04.2008 shtetasi L.L. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e kërkuesit, palë e paditur në atë gjykim, të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktmarrëveshja e datës 06.06.1995. Me vendimin nr. 10095, datë 03.12.2009, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e kërkuesit të përmbushë detyrimet e rrjedhura nga aktmarrëveshja, duke njohur paditësin pronar të dy kateve të fundit të ndërtesës 7-katëshe dhe të katit nëntokësor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.760, datë 06.04.2011, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-513, datë 08.03.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

3. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) për procesin gjyqësor të sipërcituar, duke parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të disponimit të padisë, së drejtës së mbrojtjes, parimit të paanshmërisë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata, me vendimin nr. 19, datë 22.01.2013, ka vendosur rrëzimin e saj.

4. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të sipërcituara, duke parashtruar pretendime për masën e sigurimit të padisë, bllokimin e pronës, sigurinë juridike dhe se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kishin përcaktuar gabim

natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 09.05.2014, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

5. Kërkuesi, bazuar mbi të njëjtat pretendime të paraqitura edhe në kërkesën e tij përpara Gjykatës, ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr.00-2014-2612, datë 03.10.2014, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatë dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 229, datë 17.11.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

#### *Procesi penal*

6. Pas përfundimit të procesit gjyqësor civil, në dhjetor të vitit 2015, me pretendimin se ekspertet E.F. dhe E.L. të thirrura në atë proces nuk kanë pasqyruar të vërtetën në aktin e ekspertimit të kryer nga ana e tyre, kërkuesi ka paraqitur kallëzim kundër këtyre shtetaseve. Mbi këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 1103, datë 23.02.2016 për veprën penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309, paragrafi 1, i Kodit Penal (KP). Në vijim, me vendimin e datës 28.06.2017, ajo ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal me arsyetimin se në rastin konkret nuk plotësohen elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale, të parashikuar nga neni 309, paragrafi 1, i KP-së dhe se, pavarësisht kësaj, për shkak të kohës që ka kaluar nga kryerja e veprimit, aktit të ekspertimit të datës 03.11.2009, ndjekja penale për këtë figurë vepre penale është parashkruar.

7. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11 akti, datë 10.05.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të tij, me arsyetimin se vendimi i prokurorisë për pushimin e procedimit penal është i drejtë, ndërsa ajo ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi dhe mbi bazën e tyre ka arritur në konkluzionin se duhet vendosur pushimi i çështjes penale. Sipas asaj gjykate, akti i ekspertimit i paraqitur nga ekspertet i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe vendimi i dhënë nga gjykata, që është bazuar edhe te ky aktekspertimi, i ka kaluar të gjitha shkallët e gjykimit, përfshirë edhe Gjykatën. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2142, datë 10.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 11 akti, datë 10.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të njëjtin arsyetim. Kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-503, datë 21.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

9. Në datën 23.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.10.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi i ka cenuar:

10.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë ka pasur pengesë ligjore, sepse ka gjykuar më parë çështjen civile për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për masën e sigurimit të padisë së shtetasit L.L., duke iu referuar një vendimi që nuk ekziston, ndërkohë që për ekzistencën e dy vendimeve për masën e sigurimit të padisë të dhënë nga një gjyqtar tjetër, me të njëjtin numër dhe datë, por me dispozitiv të ndryshëm, ai gjyqtar nuk e ka referuar rastin në prokurori dhe ka lejuar bllokimin e të gjithë ndërtesës. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e këtij gjyqtari ajo është rrëzuar. Po kështu, në vendimin objekt kundërshtimi gjyqtari ka dhënë përfundime të njëanshme, duke arritur në të njëjtin konkluzion me organin e akuzës. Pavarësisht se gjykata ka refuzuar marrjen si provë nga ekspertja të faturës tatimore dhe nuk ka riçelur hetimin gjyqësor, në vendim e ka cituar këtë faturë. Edhe gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë gjykuar çështje të tjera penale dhe civile që lidhen me palët në gjykim. Ajo gjykatë nuk e ka njoftuar kërkuetin për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues një ditë përpara gjykimit të çështjes, duke i cenuar të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre. Anshmëria e gjyqtarëve të kësaj gjykate konstatohet edhe nga fakti se ata kanë konsideruar se fakti penal nuk ekziston, ndonëse kjo nuk rezulton e vërtetë.

10.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi ndonëse kërkuesi ka paraqitur kallëzim për tre vepra penale, prokuroria padrejtësisht ka regjistruar procedimin penal vetëm për një nga ato, ndërkohë që gjykatat kanë justifikuar këtë veprim të paligjshëm të prokurorit, i cili, referuar nenit 287, pika 1, të KPP-së, duhet të regjistrojë çdo

njoftim për veprat penale dhe të arsyejojë për çdo akuzë që bëhet në kallëzim. Edhe për sa i përket veprës penale të ekspertimit të rremë, ajo duhet të ishte regjistruar si e kryer më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda. Prokuroria nuk ka kryer hetime për veprat penale të zbuluara gjatë hetimit paraparak për shtetasit e tjerë, përkatësisht shtetasin L.L. dhe avokaten F.Gj., emri i të cilëve nuk është regjistruar. Gjykatat padrejtësisht kanë pranuar se prokuroria ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi, në një kohë kur ajo nuk ka kryer një aktekspertimi me vlerësues pasurie, i cili do të përcaktonte pjesët takuese në bashkëpronësi dhe pronësinë e ndërtimit të themelit dhe karabinasë, të cilat i takojnë kërkuarit, ndërkohë që në aktin e ekspertimit të marrë si provë në procesin gjyqësor civil janë pasqyruar të dhëna të rreme. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën për riçelje të hetimit gjyqësor për marrjen e provave të reja. Kërkuari i është drejtuar gjykatës së apelit për plotësimin e vendimit të saj nr. 2142, datë 10.10.2018, për sa i përket shpalljes si të falsifikuar të aktit të ekspertimit të administruar gjatë procesit civil, kërkesë e cila nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë. Po kështu, gjykata e apelit nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e ankimit të kërkuarit dhe ankimit shtesë të tij, konkretisht për sa i përket mosveprimit të prokurorit në lidhje me kërkesën për kryerjen e ekspertimit me vlerësues të pasurive të paluajtshme, si dhe për shkeljen nga gjykata e shkallës së parë të nenit 378/a të KPP-së, për sa i përket kërkesës për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja që kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

- 10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi ekspertet e kallëzuara në aktin e ekspertimit të paraqitur në procesin gjyqësor civil kanë ndryshuar përmbajtjen e aktmarrëveshjes së datës 06.06.1995, duke dyfishuar sipërfaqet dhe përgjysmuar çmimet dhe, si rrjedhojë e kësaj, gjykatat dhe prokuroria kanë lejuar që kërkuari të mos disponojë asnjë sipërfaqe në katet 6 dhe 7 të ndërtesës. Në aktin e ekspertimit nuk është përdorur aktmarrëveshja e lidhur mes palëve. Ndonëse sipas aktmarrëveshjes kërkuari rezulton ortak në 50% të pjesëve të kapitalit, sipas aktit të ekspertimit ai rezulton i tillë vetëm për 4% të tij dhe për të nuk janë llogaritur kontributet e përbashkëta. Në këtë mënyrë atij i është cenuar e drejta e barazisë së ortakëve në shoqërinë tregtare, ndërsa bazuar në një aktekspertimi të

bërë në mënyrë të fshehtë, L.L. ka arritur të përvetësojë kontributet e tij, në shkelje të klauzolave përkatëse të aktmarrëveshjes, të cilat ekspertet as i kanë përmendur në aktin e ekspertimit. Po kështu, kërkuesi është cenuar në të drejtat reale pasurore jashtëkontraktore dhe jashtë disponimeve gjyqësore, si të drejtat e rrjedhura nga leja dhe projektet e ndërtimit, sipërfaqet ndërtimore të llogaritura për pronësinë e truallit dhe të investimeve në ndërtim krahas kontributeve të veçanta të kërkuesit në vitet 1992-1995, përpara lidhjes së aktmarrëveshjes me shtetasin L.L., ndërsa gjykatat në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk kanë lejuar kryerjen nga prokuroria të një akteksptimi vlerësues, i cili të përcaktonte se kujt i përkasin këto të drejta.

10.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë të paargumentuara, të pambështetura në prova, kontradiktore dhe u mungon arsytimi, përveçse kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në ankim dhe në rekurs, përfshirë edhe për kryerjen e një ekspertimi vlerësues të pasurisë. Nga njëra anë, gjykatat kanë pranuar se ekspertet nuk kanë vepruar me dashje, ndërsa, nga ana tjetër, janë shprehur se nuk mund të ushtrohet ndjekja penale për shkak të plotësimit të afateve të parashkrimit të veprës penale, çka e bën kontradiktor vendimin e tyre. Gjykatat nuk kanë zgjidhur çështjen që lidhet me përdorimin e aktit të ekspertimit me të dhëna të rreme dhe pasojave të tij vazhduese. Gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, pasi ato duhet të kontrollojnë saktësinë e veprimeve hetimore dhe kualifikimin e veprave penale të kallëzuara. Gjithashtu, ato kanë gabuar kur arsyetojnë se nga ana e prokurorit janë grumbulluar të gjitha provat dhe janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Sipas gjykatave, ekspertet i janë përgjigjur vetëm detyrave të caktuara, arsytim i cili nuk gjen mbështetje në ligj dhe provohet se gjykatat në procesin gjyqësor civil kanë dalë jashtë objektit të konfliktit dhe aktmarrëveshjes midis palëve. Prokuroria ka bërë një interpretim të gabuar të veprës penale të ekspertimit të rremë, pasi është provuar se plotësohen të katër elementet e saj dhe ekspertet kanë ndërruar sipërfaqet dhe çmimet kontraktore. Po kështu, është zbatuar gabim neni 66 i KP-së për afatin e parashkrimit, pasi prokuroria nuk mund të ndalojë procesin pa u vërtetuar ekzistenca e veprës penale, afati llogaritet për veprën penale më të rëndë dhe kjo vepër është vazhduese. Akti i

ekspertimit nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në asnjë shkallë të gjykimit civil, pasi në të dyja gjykatat e faktit kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit.

10.2. *Të drejtën e pronës*, pasi në mungesë të veprimit të gjykatave për të goditur veprën penale të ekspertimit të rremë dhe ndërprerjes së veprimit të mëtejshëm në drejtim të pasojave të rënda përvetësuese të pronës, kërkuesi është në kushtet e shpronësimit *de facto* të saj, për sa kohë me anë të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara gjykatat kanë vazhduar ta privojnë kërkuesin nga e drejta e pronës.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kolegji vëren se edhe pse në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme të dhëna gjatë procesit penal, në përmbajtje të tij ai ka ngritur pretendime edhe për vendimet e dhëna gjatë procesit gjyqësor civil, duke pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i të dhënave të rreme të pasqyruara në aktin e ekspertimit të përgatitur nga ekspertet e kallëzuara prej tij, i cili është akti ku gjykatat kanë bazuar vendimet e tyre. Në lidhje me këto të fundit, Kolegji vëren se janë marrë më parë në shqyrtim nga kjo Gjykatë (*shih paragrafin 3 të vendimit*), ndaj, në kuptim të përmbajtjes së nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, ato nuk mund të merren më në shqyrtim. Për rrjedhojë, në vijim shqyrtimi do të kufizohet vetëm në lidhje me vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit penal.

13. Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar, ndërsa ajo lidhet me procesin gjyqësor civil të përmbyllur me vendim përfundimtar që ka vendosur për të drejtën substanciale të pronës të pretenduar, si e cenuar nga kërkuesi, në kuptimin se rezultati i procesit penal të kundërshtuar mund të ndikojë në procesin gjyqësor civil në rrethanat kur një rezultat i caktuar i procesit penal mund të përbëjë shkak për rishikimin e vendimit civil përfundimtar referuar ligjit procedural civil.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Kolegji evidenton se kërkuesi një pretendim të tillë e ka ngritur edhe ndaj gjyqtarit i cili ka gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë, duke parashtruar dy argumente. Konkretisht, kërkuesi argumenton se gjyqtari ka pasur pengesë ligjore, sepse ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e marrjes së masës së sigurimit të padisë. Kolegji vëren se kërkuesi ka përdorur mjetin ligjor, duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, ndërsa kërkesa e tij për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes është rrëzuar. Po kështu, kërkuesi argumenton se njëanshmëria e gjyqtarit rezulton edhe nga vendimet e ndërmjetme të marra nga ai gjatë gjykimit të çështjes, sikundër edhe nga vendimi përfundimtar. Këto pretendime për njëanshmërinë e gjyqtarit të shkallës së parë kërkuesi i ka parashtruar në ankimin në gjykatën e apelit. Megjithatë, në rekursin në Gjykatën e Lartë kërkuesi nuk ka ngritur pretendime për njëanshmërinë e gjyqtarit të shkallës së parë, duke i paraqitur ato në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për këtë pretendim.

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit edhe me argumentin se ndonëse ai i është drejtuar gjykatës së apelit për plotësimin e vendimit të saj nr. 2142, datë 10.10.2018, për shpalljen si të falsifikuar të aktit të ekspertimit të administruar gjatë procesit civil, kjo kërkesë nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë. Kolegji çmon se për sa kohë që për këtë çështje nuk ka një vendim



përfundimtar dhe kërkuesi nuk ka përdorur mjetet juridike në dispozicion, ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

17. Kolegji konstaton se, po në drejtim të së drejtës së aksesit kërkuesi ka pretenduar edhe se gjykata e apelit nuk është shprehur për pretendimin e tij në ankim për shkeljen nga gjykata e shkallës së parë të nenit 378/a të KPP-së sa i përket kërkesës për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja që kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes, konkretisht të disa akteve në lidhje me kallëzimin e bërë nga ai ndaj gjyqtarëve që kishin marrë pjesë në procesin gjyqësor civil. Referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se një pretendim të tillë kërkuesi nuk e ka ngritur as në ankimin në gjykatën e apelit, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ai nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të ngritur për këtë argument.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për sa i përket gjykimit në gjykatën e apelit, së drejtës së aksesit, standardit të arsytimit dhe së drejtës së pronës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit që ka përmbyllur procesin penal të nisur për kallëzimin penal të tij. Për rrjedhojë, ai e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

19. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsytuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.03.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë fillimisht në datën 23.09.2024. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 14.05.2024, ndërsa vet kërkuesi ka pretenduar se është vënë në dijeni të këtij vendimi në datën 23.05.2024. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues rezulton se në parashtrimet e depozituara nga mbrojtësi ligjor i kërkuesit janë lënë të dhënat elektronike të tij, por nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë njoftuar

vendimin në adresën e postës elektronike. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se në çështjen konkrete si moment i konstatimit të cenimit do të konsiderohet data 23.05.2024. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

21. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit me argumentin se prokuroria padrejtësisht ka regjistruar procedim penal vetëm njëherë nga veprat penale të kallëzuara dhe vetëm për ekspertet; gjykatat padrejtësisht kanë pranuar se prokuroria ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi, në një kohë kur ajo nuk ka pranuar kryerjen e aktit të ekspertimit me vlerësues pasurie, i cili do të përcaktonte pjesët takuese në bashkëpronësi dhe pronësinë e ndërtimit të themelit dhe karabinasë, të cilat i takojnë kërkuesit; gjykata e apelit nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e ankimit. Nisur nga thelbi dhe përmbajtja e këtij pretendimi, Kolegji vlerëson ta analizojë të ndërlidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

22. Për sa i përket pretendimit për cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarët në gjykatën e apelit ndodhen në kushtet e njëanshmërisë, ndërsa ata kanë gjykuar çështje të tjera penale dhe civile që lidhen me palët në gjykim. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt bindës për të argumentuar cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme, për sa i takon testit objektiv. Për më tepër, rezulton se Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, duke u shprehur se kërkuesi nuk përmend asnjë nga rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim, të parashikuara nga nenet 15 e vijues të KPP-së, duke e konsideruar këtë pretendim të pabazuar (*shih paragrafin 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se procesi penal objekt kërkese është i lidhur në thelb me procesin gjyqësor civil ku është vendosur për të drejtën e tij të pronës, për sa kohë mund të ndikojë dhe të sjellë efekte në këtë të fundit (përmes mjetit juridik të rishikimit të vendimit të formës së prerë), vlerëson që ta analizojë këtë pretendim në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

24. Në përfundim, Kolegji çmon të analizojë në vijim pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*

25. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se prokuroria padrejtësisht ka regjistruar procedim penal vetëm njëherë nga veprat penale të kallëzuara dhe vetëm për ekspertet; gjykatat padrejtësisht kanë pranuar se prokuroria ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi, në një kohë kur ajo nuk ka pranuar kryerjen e aktit të ekspertimit me vlerësues pasurie, i cili do të përcaktonte pjesët takuese në bashkëpronësi dhe pronësinë e ndërtimit të themelit dhe karabinasë, të cilat i takojnë atij; gjykata e apelit nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e ankimit. Po kështu, vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë të paargumentuara, të pambështetura në prova, kontradiktore dhe u mungon arsytimi, si dhe kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në ankim dhe rekurs, përfshirë kryerjen e ekspertimit nga vlerësues të pasurisë. Gjykatat nuk kanë zgjidhur çështjen që lidhet me përdorimin e aktit të ekspertimit me të dhëna të rreme dhe pasojave të tij vazhduese, kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, pasi ato duhet të kontrollojnë saktësinë e veprimeve hetimore dhe kualifikimin e veprave penale të kallëzuara. Gjithashtu, ato kanë gabuar kur arsyetojnë se nga ana e prokurorit janë grumbulluar të gjitha provat dhe janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Sipas gjykatave, ekspertet u janë përgjigjur vetëm detyrave të caktuara, arsytim i cili nuk gjen mbështetje në ligj dhe provohet se gjykatat kanë dalë jashtë objektit të konfliktit dhe aktmarrëveshjes midis palëve. Prokuroria ka bërë një interpretim të gabuar të veprës penale dhe është zbatuar gabim neni 66 i KP-së për afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Akti i ekspertimit nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në asnjë shkallë të gjykimit, pasi në të dyja gjykatat e faktit kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit.

26. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje

përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Megjithatë, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, sikurse pretendon edhe kërkuesi, në rastin konkret. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

29. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese, Kolegji çmon të analizojë nëse gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm qëndrimet e tyre në lidhje me pretendimet e kërkuesit për kallëzimin e paraqitur prej tij dhe u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të tij në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje prej tij.

30. Në rastin në shqyrtim, për sa i përket kallëzimit të paraqitur nga kërkuesi, Kolegji vëren se prokuroria, bazuar në nenin 328, shkronjat “b” dhe “d”, të KPP-së, ka vendosur pushimin e procedimit penal të regjistruar prej saj për veprën penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309, paragrafi 1, i KP-së, kundër eksperteve E.F. dhe E.L., me argumentin se nuk plotësohen elementet e anës objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale, për sa kohë, pavarësisht një pasaktësie në llogaritjen referuar ekspertimit kontabël të realizuar gjatë hetimit, nuk rezulton që ekspertet e kallëzuara të kenë dhënë një rezultat të rremë në aktin e ekspertimit të përpiluar nga

ato gjatë procesit gjyqësor civil, përveçse ato nuk rezultojn të kenë vepruar me dashje direkte për pasqyrimin e një rezultati të tillë ndërsa kanë përmbushur detyrën, duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga gjykata. Pavarësisht kësaj, sipas prokurorisë, për shkak të kohës që ka kaluar nga kryerja e veprimit, aktit të ekspertimit të datës 03.11.2009, ndjekja penale për këtë veprë është parashkruar. Gjykata e shkallës së parë, e vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuarit, e ka gjetur të drejtë vendimin e prokurorit, duke arsyetuar se është organi i prokurorisë, i cili kryen hetimet dhe bën kualifikimin e veprës penale, që në rastin konkret përkon me veprën penale të ekspertimit të rremë, duke përjashtuar dispozitat e përgjithshme penale. Për të përcaktuar vërtetësinë e aktit të ekspertimit prokurori ka urdhëruar kryerjen e një ekspertimi kontabël dhe ka grumbulluar provat e nevojshme. Për sa i përket faktit se ekspertet nuk kanë përdorur të gjitha dokumentet e nevojshme, kjo gjykatë ka vlerësuar se legjislacioni e detyron ekspertin të japë mendim në bazë të provave të administruara në gjykim dhe rezultojn se ato u janë përgjigjur pyetjeve të gjykatës. Nga ana tjetër, ndonëse në aktin e ekspertimit konstatohen mangësi, është përmbushur afati i parashkrimit për ndjekjen e veprës penale. Në përfundim gjykata ka vlerësuar se organi i prokurorisë ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi dhe se akti i ekspertimit i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe vendimi i dhënë nga gjykata, që është bazuar edhe te ky akt ekspertimi, i ka kaluar të gjitha shkallët e gjykimit, përfshirë edhe Gjykatën (*shih faqet 13-15 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

31. Në të njëjtën linjë arsyetimi është shprehur edhe gjykata e apelit, e cila ka evidentuar se ajo duhet të analizojë nëse prokurori i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, ose duhet të kryhen veprime të tjera hetimore, të cilat janë të rëndësishme për çështjen, ndërsa vlerësimi i fakteve të mbledhura gjatë hetimit dhe cilësimi juridik i rrethanave të hetuara paraprakisht mbeten ekskluzivitet i prokurorisë dhe asnjë subjekt nuk mund të ndërhyjë me autoritetin e tij në fazën e veprimeve paraprake hetimore. Kjo gjykatë ka vlerësuar se nga ana e prokurorit janë grumbulluar të gjitha provat e nevojshme dhe janë kryer veprime hetimore të plota dhe nuk rezultojn ndonjë veprim hetimor, i pakryer, që është i rëndësishëm për çështjen, për më tepër kur ndjekja penale ndaj eksperteve të kallëzuara është parashkruar (*shih faqet 14-15 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

32. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se pretendimet e tyre nuk u referohen shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kjo gjykatë ka vlerësuar se Gjykata e Apelit Tiranë, si gjykatë fakti dhe ligji, mbi ankimin e kallëzuesit ka marrë në shqyrtim të gjitha shkaqet e ankimit; sipas gjykatave më të

ulëta nga ana e prokurorit janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme e të domosdoshme për hetimin e veprës penale dhe vendimet e tyre janë të arsyetuara mjaftueshëm; për sa i përket faktit se prokurori ka regjistruar procedimin penal vetëm për një vepër penale, akuzat nuk i përcakton pala që bën kallëzimin, por prokurori në përfundim të hetimeve paraprahe, ndërkohë që KP-ja ka parashikuar në një dispozitë të posaçme rastet e ekspertimeve të rreme, që është neni 309 i saj, ndaj, për rrjedhojë, ekspertët për kryerjen e akteve të ekspertimit të rremë mund të përgjigjen vetëm për veprën penale të ekspertimit të rremë, për pasojë edhe përfundimi i gjykatës së apelit për parashkrimin e ndjekjes penale të veprës penale është i drejtë dhe i bazuar në ligj; nuk konstatohet mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 24 - 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

33. Nga sa më lart, Kolegji evidenton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit kanë pasqyruar veprimet hetimore të kryera nga prokurori, deklaratimet e kërkuarit dhe ato të eksperteve të kallëzuara. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se prokurori, nga njëra anë, ka pranuar se akti i ekspertimit ka pasaktësi, por, nga ana tjetër, ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të veprës penale, Kolegji evidenton se prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nëpërmjet ankimit kushtetues individual, kanë pranuar si shkak kryesor për pushimin e procedimit penal atë se fakti i provuar nuk përmban të gjitha elementet e figurës së veprës penale që dyshohej se ishte kryer, pra se ai nuk parashikohet nga ligji si vepër penale (neni 328, shkronja “b”, i KPP-së). Në vijim, për më tepër, nga ato është pranuar si shkak për pushimin e procedimit penal edhe ai i parashkrimit të ndjekjes penale (neni 328, shkronja “d”, i KPP-së). Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se, sikurse kërkuari pretendon, duket se ka një kontradiktë mes shkaqeve për të cilat procedimi penal është pushuar, por se pavarësisht kësaj, një kontradiktë e tillë nuk tregon se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk përmbushin standardet e arsyetimit dhe as se gjykatat e faktit kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për akses, përderisa ai ka marrë përgjigje për pretendimet e ngritura në ankimet e paraqitura përpara tyre. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se gjykatat padrejtësisht kanë pranuar se prokuroria ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt hetimi, në një kohë kur ajo nuk ka kryer një aktekspertimi me vlerësues pasurie, Kolegji çmon se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje duke evidentuar faktin se ekspertet e kallëzuara kanë dhënë mendim në bazë

të provave të administruara në gjykim duke iu përgjigjur pyetjeve të gjykatës, ndërkohë që akti i tyre i ekspertimit, mbi ankimin e kërkuarit, i është nënshtruar kontrollit të gjykatave në procesin gjyqësor civil, çka do të thotë se e kanë vlerësuar atë si të panevojshëm. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuarit për kryerjen e një ekspertimi tjetër vlerësues, duke u bazuar në dokumente dhe çështje të ngritura nga ai, duket se kapërcen objektin e hetimit penal dhe në fakt lidhet me drejtësinë e vendimit të dhënë në procesin gjyqësor civil.

34. Po kështu, Kolegji vlerëson se kërkuari ka ushtruar lirisht të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, duke marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura, veçanërisht në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për sa u përket gjyqtarëve të gjykatës së apelit dhe pretendimeve kryesore që lidhen me vendimin e kësaj gjykate, e cila, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka konfirmuar vendimin e prokurorisë për pushimin e procedimit penal. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor në funksion të aksesit në gjykatë, duke shqyrtuar vetëm ato çështje që i parashikon ligji. Gjithashtu, referuar edhe standardeve kushtetuese për arsyetimin e vendimeve, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë e ka përmbushur detyrimin e saj për arsyetimin e vendimit, për sa kohë në vendim janë paraqitur vendimmarrja e gjykatave më të ulëta, pretendimet e kërkuarit dhe argumentet përkatëse në drejtim të pabazueshmërisë së pretendimeve. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.